

# RAPORT MONITORIMI Nr. 5

**mbi kufizimet e  
përdorimit  
të burimeve  
shtetërore në  
fushatën  
zgjedhore**

*Periudha*

*25 mars – 25 prill 2021*

**Raportues:**  
**Isuf Shehu, Gerta Meta**  
(Alumni të ASP)

Me bashkëpunimin e  
pedagogëve dhe stu-  
dentëve monitorues  
pranë universiteteve  
në shtatë rajone të  
vendit

## *Projekti*

*"Forcimi i Transparencës  
së Zgjedhjeve në Shqipëri"*

Ky projekt mbështetet nga ambasada e Mbretërisë së Holandës në Tiranë dhe programi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian "Aksioni kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri"



Kingdom of the Netherlands

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe

Ky raport pasqyron gjetjet e monitorimit të zbatimit të dispozitave të reja të Kodit Zgjedhor, në drejtim të:

- Praktikës ligjore dhe institucionale për zbatimin e kufizimeve mbi burimet shtetërore gjatë fushatës zgjedhore;
- Procesit të raportimit dhe kontrollit të veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve qendrorë dhe vendorë;
- Aktet ligjore të miratuara në shkelje të ndalimeve të parashikuara në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve.

Në raportin vijuese do të pasqyrohen gjetjet e kufizimeve të tjera gjatë fushatës zgjedhore me fokus sjelljen e administratës shtetërore, përdorimin e aseteve publike dhe kufizimet për materialet propagandistike të subjekteve elektorale.

### Praktika ligjore dhe institucionale për zbatimin e dispozitave

Më 25 mars, me nisjen zyrtare të fushatës zgjedhore, hynë në fuqi kufizime të mëtejshme të Kodit Zgjedhor për përdorimin e burimeve publike, sjelljen e administratës shtetërore si dhe shpenzimet për materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore. Në këtë situatë të re, por edhe me shtimin e aktiviteteve politike, u konstatua një rritje e denoncimeve nga partitë politike, OJF si dhe qytetarë në ndërfaqen e aktiviteteve të ndaluara (<https://aktivitete.kqz.gov.al/>) si dhe portalin e denoncimeve (<http://kqz.gov.al/kallzo>) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas të dhënave zyrtare të KQZ, deri më 25 prill, u regjistruan gjithsej 95 denoncime për shkelje të ndryshme të parashikuara në [Vendimin nr.9/2020](#) për përdorimin e burimeve shtetërore në periudhën zgjedhore. Konfirmohet se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar dhe marrë vendim për 43 raste të denoncuar, duke caktuar:

- 3 masa administrative gjobë (çështja ndaj Drejtorit të Kadastrës Lushnjë dhe kryetarëve të bashkisë Tiranë dhe Vorë)

- 5 njoftime për marrje masash (*Bashkisë Tropojë për aktivitetet publike me prezencën e kandidatit të PS - bashkisë Librazhd dhe PS në Kamëz për vendosjen e materialeve propagandistike - 2 njoftime policisë bashkiake për mbyllje zyresh elektorale pranë Qendrave të Votimit të PS në Gjirokastrë dhe PD në Tiranë*)
- 24 çështje të përfunduara pa konstatim shkelje;
- 11 çështje për mosfillim procedure (raste jashtë kompetencës)

*Lista e plotë e denoncimeve dhe vendimeve përkatëse mund të konsultohet në [Aneksin 2](#)*

Vendimmarrja e kësaj periudhe të fundit nga ana e Komisionerit mund të konstatohet se ka qënë tepër e ngjeshur. Vlen të theksohet se nga data 2 – 24 prill janë shqyrtuar 36 denoncime të mbërritura në të dyja portalet online të ndërtuara nga KQZ, por siç mund të konstatohet, në pjesën më të madhe është vendosur për mbylljen e shqyrtimit administrativ për shkak të “moskonstatimit të shkeljeve të dispozitave të Kodit Zgjedhor”.

Mes denoncimeve për të cilat është vendosur rrëzimi janë edhe ato mbi kontratat koncesionare apo marrëveshjet PPP për investime strategjike si portet dhe aeroportet, të miratuara gjatë javëve të fundit para zgjedhjeve,

të cilat janë argumentuar nga ministritë përkatëse si vijim i procedurave të nisura përpara hyrjes në fuqi të kufizimeve të Kodit Zgjedhor si dhe për të cilat nuk janë vendosur fonde të posaçme në dispozicion.

Gjithashtu, Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) ka lënë në fuqi gjatë kësaj periudhe masën administrative në vlerën e 10.000 lekëve të Komisionierit ([Vendim nr. 234 / 14.04.2021](#)), ndaj z. **Gentian Picari, kryetar në detyrë i Bashkisë Vorë**, i denoncuar nga LSI për mosfunksionimin e faqes zyrtare të internetit të bashkisë, duke sjellë pamundësinë e publikimit të vendeve publike në territorin e bashkisë për afishimin e materialeve propagandistike (nenit 79, pika 1 të Kodit Zgjedhor). **Ky vendim mbetet deri më sot e vetmja masë ndëshkuese ndaj një zyrtari të lartë në kuadër të kufizimeve të Kodit Zgjedhor, e mbetur në fuqi edhe pas shqyrtimit në KAS.**

Duke mos zhgënjyer parashikimin, ankesa e regjistruar më 10.03.2021 pranë Gjykatës Administrative Tiranë, për rrëzimin nga KAS të **procedimit administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj**, ende nuk është marrë në shqyrtim. Për çështjen e regjistruar me nr. 31138-01809-80-2021 janë zhvilluar aktualisht dy seanca përgatitore nga kjo gjykatë, në të cilat është kërkuar që të ketë një opinion të Gjykatës së Lartë mbi kompetencat e gjykatës administrative për të shqyrtuar çështjen në fjalë. Kujtojmë se edhe Kolegji Zgjedhor, u shpreh më parë ([vendimi nr. 2](#), datë 04.03.2021) për “*mungesën e kompetencës lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesë padie*”.

Ashtu siç ishte paralajmëruar në raportet e mëparshme, problematika në zbatimin e kufizimeve të Kodit Zgjedhor për shkak të përcaktimeve evazive ligjore, e përforcuar më tej me rregullimet lehtësuese të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ, por edhe praktika e interpretimeve të mëtejshme të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), **kanë zhvlerësuar plotësisht mekanizmat në dispozicion të KQZ për të ushtruar rolin kontrollues dhe sanksionues për zbatimin e kufizimeve të për-**

**dorimit të burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore.**

### Raportimi i veprimtarive publike






Zyrtarët e lartë publikë qendrorë dhe vendorë ngarkohen nga [Kodi Zgjedhor](#) me detyrimin që të raportojnë paraprakisht pranë KQZ veprimtaritë e tyre publike në periudhën 4-mujore para zgjedhjeve. Deri më 25 prill, në ndërfaqen (<https://aktivitete.kqz.gov.al/>) rezultojnë se janë raportuar gjithsej **1.229 aktivitete nga institucionet publike qendrore dhe vendore**. Edhe gjatë kësaj periudhe, **KQZ nuk ndaloi ndonjë veprimtari publike të raportuar nga zyrtarët**, një detyrë e caktuar nga Kodi Zgjedhor në rastet kur konstatohet se veprimtaritë përbëjnë shkelje të kufizimeve të përcaktuara.

### Monitorimi në terren SETA




Gjatë kësaj periudhe, projekti SETA ka vazhduar monitorimin e aktiviteteve promovuese të anëtarët të kabinetit qeveritar dhe kryetarëve të bashkive në shtatë qytete kryesore të vendit. Këto veprimtari në faqet zyrtare online të institucioneve, mediat lokale si dhe profilet e këtyre zyrtarëve në rrjete sociale (kryesisht Facebook), u kryqëzuan më pas me të dhënat e raportimeve të këtyre institucioneve në ndërfaqen e KQZ, për të sjellë një analizë të ecurisë së procesit të raportimit dhe disa rekomandime të mëtejshme.

Nisja e fushatës zgjedhore sigurisht që shtoi numrin e aktiviteteve publike dhe promovimeve të investimeve nga zyrtarët publikë, një pjesë e të cilëve ishin tashmë në rolin e kandidatit dhe në pozita konkurrimi përballë kandidatëve të forcave të tjera politike. Mund të konstatohet se procesi i raportimit nga ana e ministrave të veshur në rolin e kandidatëve është kthyer gjatë kësaj periudhe në një proces burokratik dhe që e ka humbur sensin. Kryeministria dhe disa prej ministrive (Financave, Arsimit, Bujqësisë) kanë vazhduar të raportojnë aktivitete elektorale si takimet me struktura partiake apo edhe grupime të ndryshme intere-

**Tabela përmbledhëse e aktiviteteve të zyrtarëve të lartë qendrorë dhe vendorë në periudhën 25 mars – 25 prill 2021**

	Zyrtarë subjekt i raportimit	Raportime në KQZ*	Promovime të paraportuara**
	Kryeministri	137	25
	Ministri i Mbrojtjes	0	4
	Ministri i Brendshëm	1	8
	Ministri i Drejtësisë	2	2
	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	56	2
	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	19	1
	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	26	5
	Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme	0	3
	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	5	11
	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	0	3
	Ministri i Kulturës	5	2
	Ministri i Mjedisit dhe Turizmit	0	1
	Ministri i Shtetit për Diasporën	0	0
	Ministri i Shtetit për Rindërtimin	1	2
	Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	0	2
	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	0	1

**KRYETARËT E BASHKIVE**

	Tiranë	13	16
	Durrës	18	3
	Shkodër	2	2
	Elbasan	12	1
	Vlorë	0	0
	Korçë	0	2
	Gjirokastër	0	0

\*Të dhëna zyrtare nga ndërfaqja e raportimeve e KQZ për periudhën nën monitorim.

\*\*Vizita apo postime promovuese të investimeve në infrastrukturë dhe objekte publike që mund të përbëjnë shkelje në mungesë të raportimit

si, aktivitete të cilat është e vështirë të kategorizohen si promovime investimesh publike, për të cilat kërkohet raportimi paraprak pranë KQZ, apo vetëm takime të agjendës normale të një fushate. Në të njëjtën pozitë janë vendosur edhe kryetarët e bashkive nën monitorim, të cilët kanë zhvilluar takime të përditshme gjatë fushatës në shoqërinë e kandidatëve në zona të ndryshme të njësive të drejtuara prej tyre, ku nuk kanë munguar edhe promovimet e investimeve të kryera nga bashkia në periudha të ndryshme kohore. Intensiteti i fushatës dhe formatet e takimeve elektorale, e bëjnë të pamundur një vlerësim të drejtë të masës së aktiviteteve të raportuara nga ana e subjekteve të monitoruara.



Listën e plotë të veprimtarive të zyrtarëve të monitoruar që nga hyrja në fuqi e kufizimeve të Kodit Zgjedhor mund t'i gjeni në databazën e projekteve tonë: [monitorimi.asp.al](http://monitorimi.asp.al)

### Monitorimi i akteve normative

Në funksion të Nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, janë monitoruar Aktet Normative dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilët janë botuar në Fletoren Zyrtare për periudhën 25 mars – 25 prill 2021.

Rezultojnë si vendime në shkelje të Kodit Zgjedhor:

- 1 vendim i Këshillit të Ministrave
- 4 vendime të Këshillave Bashkiakë

të cilat sjellin **përfitime apo masa lehtësuese** për periudhën katër mujore para zgjedhjeve.

Më konkretisht aktet e miratuara mund të konsultohen në [Aneksin 1](#)

Raporti nuk ka përfshirë në listën e vendimeve të konstatuara në shkelje të Kodit Zgjedhor vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës të denoncuar nga Partia Demokratike, të cilat kanë akorduar grante për rindërtimin e baneve të dëmtuara nga tërmeti në periudhën parazgjedhore shkurt – prill 2021.

Neni 91, pika 4 i Kodit Zgjedhor përcakton ndalimin për: “...propozimin, miratimin ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”

Bazuar mbi këtë përcaktim, grantet për banesat e dëmtuara nga tërmeti janë konsideruar si fonde të lidhura me fatkeqësinë natyrore dhe si të tilla jo të ndaluara.

Gjithashtu, interpretimi i kësaj fryme të Kodit Zgjedhor në mënyrë lehtësuese nga Vendimi nr.9/2020 i Komisionit Rregullator, duke përcaktuar korrelacionin me “vendosjen rishtazi të fondeve në dispozicion për një aktivitet të ndaluar”, ka aministuar çdo akt ligjor apo kontrata koncensionare të muajve të fundit të denoncuar si dyshimta për favorizim dhe përdorim të burimeve shtetërore. Në disa vendime të fundit të Komisionerit në lidhje me denoncimet për kontratat koncensionare në periudhën parazgjedhore, është argumentuar se buxheti i shtetit për vitin 2021 është draftuar dhe propozuar për miratim nga Ministria e Financave në muajin nëntor 2020, pra përpara hyrjes në fuqi të kufizimeve të Kodit Zgjedhor (26 dhjetor). Sigurisht, këto dyshime mbi një vendimmarrje të qëllimshme të Këshillit të Ministrave dhe Këshillave Bashkiakë për të orientuar votat, do të ishin evituar lehtësisht në rast se vendimet do të miratoheshin pas datës 25 prill.



Listën e plotë të akteve të miratuara që nga hyrja në fuqi e kufizimeve të Kodit Zgjedhor mund t'i gjeni në databazën e projektit tonë: [monitorimi.asp.al](http://monitorimi.asp.al)

## Rekomandime

Është tashmë e qartë se roli që iu ngarkua KQZ si një rojtare e çdo shkeljeje të subjekteve politike dhe zyrtarëve të lartë shtetërore në periudhën parazgjedhore, nuk u shoqërua me kompetenca të duhura për të zhvilluar hetime administrative, shtimin e burimeve njerëzore si dhe mbështetjen e duhur institucionale për të evituar vonesat dhe dekurajimin e vendimmarrjes. Rekomandohet që këto problematika të hasura të gjejnë një zgjidhje në rregullimet apo reformën e ardhshme zgjedhore së bashku me demonstrimin e një vullneti të mëtjshëm të aktorëve politikë për të evituar keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Pa një vullnet të tillë, çdo rregullim ligjor do të jetë i vështirë që të ndalojë keqpërdorimin e drejtëpërdrejtë apo të tërthortë të burimeve shtetërore.

Përsa i përket kufizimeve për miratimin e akteve ligjore në periudhën zgjedhore, konstatohet se Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe këshillat bashkiakë vazhdojnë të kryejnë në mënyrë të përsëritur të njëjtat shkelje.

Edhe në rast të një vendimmarrjeje të mundshme të KQZ, mbetet e paqartë nëse ajo ka kompetencat e duhura mbi këto institucione legjislative dhe normuese në hierarkinë institucionale të vendit.

Duhet nënvizuar se kufizimi për miratimin e marrëveshjeve koncensionare apo PPP mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të fushatës zgjedhore, deri në krijimin e qeverisë së re, me gjasa deri në muajin shtator. Vazhdimi i miratimit në shkelje të Kodit Zgjedhor i legjislacionit dhe akteve të tjera normative nga organet më të rëndësishme në vend, do të jetë një goditje e mëtjshme për ndërtimin e besimit të qytetarëve ndaj shtetit ligjor.

### Hartoi raportin:

**Isuf Shehu - Gerta Meta**



## ANEKS 1 – Aktet normative në shkëlqje të Kodit Zgjedhor

Konstatohen në shkëlqje të nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, ku ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë uljen ose heqjen e taksave:

**1. Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 50, datë 06.04.2021;** *“Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të masave për përbalimin e pasojave të infeksionit Covid-19”.*

- Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak Tiranë, nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur përjashtimin nga pagesa e detyrimit të tarifës së zënies së hapësirës publike për periudhën Prill-Shtator 2021, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e bar, restorante dhe hoteleve të klasifikuara si biznes i vogël. Gjithashtu, shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për të gjitha subjektet, deri në 20 maj 2021.

**2. Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 56, datë 06.04.2021;** *“Për trajtimin me subvencionin e qirasë së disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”.*

- Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak Tiranë, nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/familjet, sipas listës bashkëlidhur vendimit. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë do të jetë për një periudhë 1 vjecare. Efektet financiare në shumën **338,670** lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i bonusit të strehimit të Bashkisë Tiranë

**3. Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 57, datë 06.04.2021;** *“Për trajtimin me sub-*

*vencionin e qirasë së disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”.*

- Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak Tiranë, nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/familjet, sipas listës bashkëlidhur vendimit. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë do të jetë për një periudhë 1 vjecare. Efektet financiare në shumën **274,158** lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i bonusit të strehimit të Bashkisë Tiranë

**4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 21.04.2021** *“Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2021, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” - Fletore Zyrtare Nr. 64, datë 21.04.2021;*

- Këshilli i Ministrave nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur financimin, në masën 113 milionë lekë, nga fondet e buxhetit të shtetit, për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, në formën e financimit të gjysmës së pagës minimale buxhetore për rreth 508 punonjë të këtyre bashkësive fetare në Shqipëri, si dhe financimin e ndërtimit të teqesë së Elbasanit etj.,

**5. Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 68, datë 19.04.2021** *“Për trajtimin me subvencionin e qirasë të disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”.*

- Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak Tiranë, nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/familjet, sipas listës bashkëlidhur vendimit. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë do të jetë për një periudhë 1 vjecare. Efektet financiare në shumën **396,882** lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i bonusit të strehimit të Bashkisë Tiranë.

**ANEKSI 2 – Tabela e denoncimeve në ndërfaqet e KQZ-së**

Nr	Vendimi	Ndaj	Statusi	Kategoria	Data	Hapur nga
1	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	30-Dec	LSI
2	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	30-Dec	LSI
3	Vendimi 7/14.01.2021	PS -MP - Arben Qalliu	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	30-Dec	LSI
4	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	30-Dec	LSI
5	Vendimi 7/14.01.2021	PS -MP - Arben Qalliu	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	30-Dec	LSI
6	Vendimi 20/30.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	3-Jan	ISP
7	Vendimi 19/30.01.2021	Kryeministri	<b>Vendimmarrje</b>	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	4-Jan	ISP
8	Vendimi 16/28.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	5-Jan	LSI
9	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	5-Jan	LSI
10	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	5-Jan	LSI
11	Vendimi 18/30.01.2021	PS -MP - Alket Hyseni	Mosfillim	Denoncime AN - Deputet - Policia Takim	6-Jan	ISP
12	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	9-Jan	LSI
13	Vendimi 16/28.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	9-Jan	LSI
14	Vendimi 16/28.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	9-Jan	LSI
15	Vendimi 16/28.01.2021	Edi Rama; Elton Arbana	Mosfillim	Denoncime AN - Promovime Objekte Termet	9-Jan	LSI
16	Vendimi 46/09.02.2021	Edi Rama; Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	9-Jan	LSI
17	Vendimi 46/09.02.2021	Edi Rama; Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Denoncime AN - Promovime Objekte Termet	9-Jan	LSI
18	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj; Toni Gogu	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	9-Jan	LSI
19	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj; Xhemal Qefaliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pro-nesie	9-Jan	LSI



20	Vendimi 11/25.01.2021	Autoriteti ixxxxxx	Mosfillim	(7) Sinjalizim Akti- vitetete Ndaluara	11-Jan	xxx
21	Vendimi 12/25.01.2021	Bashkia Txxxxx	Mosfillim	Sinjalizime - Largim nga Puna	15-Jan	xxx
22	Vendimi 101/25.02.2021	PS -MP - Ervin Bushati	Saktësim për pjesëmarrjen e deputetit në Shkolla	Perdorim asetesh - Shkolla	15-Jan	ISP
23	Vendimi 10/25.01.2021	Erion Veliaj	Mosfillim	Perdorim asetesh - Shkolla	15-Jan	xxx
24	Vendimi 101/25.02.2021	PS -MP - Ervin Bushati	Saktësim për pjesëmarrjen e deputetit në Shkolla	Perdorim asetesh - Shkolla	15-Jan	Qendresa Qytetare
25	Vendimi 41/09.02.2021	PS-KB-Sotiraq Filo	Mosfillim	Denoncime AN - Promovime Objekte Termet	19-Jan	LSI
26	Vendimi 42/09.02.2021	PS-MP-Mimi Kodheli	Mosfillim	Denoncime AN - Deputet - Policia Takim	19-Jan	LSI
27	Vendimi 40/09.02.2021	Drejtoria Rajo- nale xxxx	Mosfillim	Sinjalizime - Largim nga Puna	24-Jan	xxx
28	Vendimi 102/25.02.2021	PS -MP - Elona Gjebrea	Saktësim për pjesëmarrjen e deputetit në Shkolla	Perdorim asetesh - Shkolla	28-Jan	Qendresa Qytetare
29	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
30	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
31	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
32	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
33	Vendimi 103/25.02.2021	Bujar Cela	Mosfillim	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
34	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
35	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI
36	Vendimi 200 / 02.04.2021	Erion Veliaj	Perfundim pa Shkelje	Promovime Ob- jekte rindërtuara nga tërmeti	2-Shk	LSI

37	Vendimi 201 / 02.04.2021	Bashkia Durres	Perfundim pa Shkelje	Kontrata Publike/ Asete – Kalimi në përdorim privat i mirëmbajtjes së varrezave të qytetit	2-Shk	PD
38	Vendimi 104/ 26.02.2021	Bashkia Tropoje	Perfundim pa Shkelje	Promovime Investime/ objekte	10-Shk	PD
39	Vendim 140/ 10.03.2021 & Vendim 234 / 14.04.2021	Gentian Picari -Bashkia Vorë	Sanksion administrativ – Konfirmuar nga KAS	Mospërbushje Detyrime-Subjekte – Mosfunksionimi i faqes së internetit	16-Shk	LSI
40	Vendimi 122 / 8.3.2021	PS-KPD- Arben Mucaj	Mosfillim	Denoncime Kandidat per Deputet-Peregjistruar	17-Shk	xxx
41	Vendimi 202 / 06.04.2021	Keshilli i Ministrave	Perfundim pa Shkelje	Kontrata Publike/ Asete – Miratimi i VKM-së nr. 1185, datë 24.12.2020 “Për procedurat e monitorimit të qarkullimit në fushën e hidrokarbureve”	22-Shk	PD
42		Keshilli i Ministrave	Shqyrtim Paraprak	Kontrata Publike/ Asete	1-Mar	PD
43		Bashkia Kukes	Shqyrtim Paraprak	Detyrim Administrata	16-Mar	PD
44		Bashkia Tropoje	Shqyrtim Paraprak	Venie ne përdorim asetë	18-Mar	PD - Tropoje
45		Bashkia Tirane	Shqyrtim Paraprak	Venie ne përdorim asetë	18-Mar	Qendresa Qytetare
46		Bashkia Kukes	Shqyrtim Paraprak	Venie ne përdorim asetë	18-Mar	Qendresa Qytetare
47		Bashkia Tirane	Shqyrtim Paraprak	Venie ne përdorim asetë	19-Mar	Qendresa Qytetare
48		Kandidatja Edona Bilali & Shtëpia e te moshuarve Shkoder	Shqyrtim Paraprak	Venie ne përdorim asetë	19-Mar	Qendresa Qytetare
49	Vendimi 205 / 07.04.2021	Bashkia Belsh	Perfundim pa Shkelje	Afishimi i materialeve propogandistike PS	19-Mar	PD
50		ATSH	Shqyrtim Paraprak	Venie ne përdorim asetë	20-Mar	PD
51		Ministria e Financave	Shqyrtim Paraprak	Kontrata Publike/ Asete – Koncensionimi i Spitalles, Durres	23-Mar	PD

52	Vendimi 245 / 15.04.2021	Rexhë Byberi, Bashkia Tropojë	Perfundim pa Shkelje – Kryer para fillimit të fushatës	Emërime dhe largime në stafin e bashkisë	25-Mar	PD - Tropo- je
53	Vendimi 233 / 14.04.2021	Donika Hy- senaj, Sek e Përgjithshme e Prefektit Dibër	Përfundimin e shqyrtimit – Njof- tim për DAP	Angazhim i administratës në fushatë	19-Mar	PD - Diber
54	Vendimi 203 / 07.04.2021	Bashkia Tirane	Perfundim pa Shkelje	Afishimi i materia- leve propogandis- tike PS – Ekran LED në Komunën e Parisit	27-Mar	PD
55	Vendimi 246 / 16.04.2021	Rexhë Byberi, Bashkia Tropojë	Perfundim pa Shkelje – Kryer para fillimit të fushatës	Emërime dhe largime në stafin e bashkisë	3-Pri	PD - Tropo- je
56	Vendimi 247 / 16.04.2021	Petrit Malaj & Gjymnazi Asim Vokshi, Tropojë	Perfundim pa Shkelje – Kryer para fillimit të fushatës	Venie ne per- dorim asetel/ Shkolla	3-Pri	PD - Tropo- je
57	Vendimi 235 / 14.04.2021	Kastriot Gurra, Bashkia Li- brazhd	Konstatim shkelje – Urdhërim për heqjen e mate- rialit	Afishimi i materia- leve propogandis- tike PS në fasa- dën e ndërtesës së bashkisë	5 - Pri	PD - Li- brazhd
58	Vendimi 248 / 16.04.2021	Edi Rama Milva Ekonomi	Perfundim pa Shkelje – Biseda në Facebook është shkëputur nga konteksti	Përdorim I buri- meve njerëzore në fushatë – Presion ndaj administratës	5 - Pri	PD
59	Vendimi 250 / 17.04.2021	Erion Braçe	Mosfillim	Përdorim I fëmi- jëve në fushatë	24-Mar	Anonim
60	Vendimi 252 / 19.04.2021	Isuf Çelaj, Kryetar i Partisë Demokratike, Dega Tropojë	Mosfillim	Afishimi i materia- leve propogandis- tike PD – Flamur i vendosur në dron	10-Pri	xxxxx
61	Vendimi 253 / 20.04.2021	Petrit Malaj	Mosfillim	Postimi i materia- leve propogandis- tike në Facebook	25-Mar	PD - Tropo- je
62	Vendimi 255 / 20.04.2021	Petrit Malaj	Mosfillim – Njof- tim bashkisë për marrjen e ma- save	Promovimi i in- vestimeve publike në prezencën e kandidatit	22-Mar	PD - Tropo- je
63	Vendimi 256 / 20.04.2021	PD -AN	Mosfillim	Hapja e zyrave elektorale	7-Pri	Bashkia Roskovec
64	Vendimi 270 / 21.04.2021	Bledi Çuçi	Mosfillim	Materiale Pro- pagandistike në mjete private	5 - Pri	Anonim
65	Vendimi 274 / 21.04.2021	Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	Perfundim pa Shkelje –Vijimësi procedure	Kontrata Publike/ Asete – Konce- sioni për Portin në Triport, Vlorë	22-Shk	PD

66	Vendim 271/ 21.04.2021	Ogerta Manastir- liu	Mosfillimin për mungesë pro- vash	Emërime politike gjatë fushatës	25-Mar	PD
67	Vendimi 272 / 21.04.2021	Kryetari i Bash- kisë Selenicë, z. Pëllumb Binaj	Perfundim pa Shkelje –	Nuk publikohet	13-Pri	PD
68	Vendim 273 / 21.04.2021	PD - Tirane	Njoftim policisë bashkiake për të mbyllur zyrën zgjedhore	Vendndodhja e zyrave zgjedhore		Anonim
69	Vendim 267 / 21.04.2021	Bledi Çuçi	Perfundim pa Shkelje –	Vendndodhja e zyrave zgjedhore	28-Mar	PD
70	Vendim 269 / 21.04.2021	Bledi Çuçi	Njoftim policisë bashkiake për të mbyllur zyrën zgjedhore	Vendndodhja e zyrave zgjedhore	31-Mar	PD
71	Vendim 268 / 21.04.2021	Bledi Çuçi	Perfundim pa Shkelje –	Vendndodhja e zyrave zgjedhore	31-Mar	PD
72	Vendim 277 / 23.04.2021	Ogerta Manastir- liu	Perfundim pa Shkelje –	Afishimi i materi- aleve propogan- distike	13-Pri	PD
73	Vendim 278 / 23.04.2021	PS	Njoftim policisë bashkiake për heqjen e materi- alit propagan- dues	Afishimi i materi- aleve propogan- distike	19-Pri	Anonim
74	Vendim 292 / 24.04.2021	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Perfundim pa Shkelje	Kontrata Publike/ Asete	23-Mar	PD
75	Vendim 293 / 24.04.2021	Bashkia Pogra- dec	Perfundim pa Shkelje	Promovimi i in- vestimeve publike	19-Pri	Komiteti i Helsinkit
76		Bashkia Tiranë		Firmosja e kon- tratave te bane- save ne Kombinat	29-Mar	PD
77		PD		Materiale Propa- gandistike	12-Pri	Bashkia Roskovec
78		PD		Materiale Propa- gandistike	13-Pri	Denoncues
79		Frida Krifca, Drejtoreshë e Përgjithshme e AZHBR-së		Transferim i punonjësit gjatë fushatës	12-Pri	Denoncues
80		Klajdi Myzaferi, Drejtor në Dre- jtorinë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profe- sional Vlorë		Pjesëmarrje e administrates ne fushate	7- Pri	LSI
81		Anjeza Shiko, Drejtor në Dre- jtorinë Rajonale Tatimore Vlorë		Pjesëmarrje e administrates ne fushate	7- Pri	LSI

82		Françesko Muçaj, Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë		Pjesëmarrje e administrates ne fushate	7- Pri	LSI
83		Sheme Lulo, Drejtor i Ujësjellës Kanalizimeve, Bashkia Sarande		Pjesëmarrje e administrates ne fushate	15-Pri	LSI
84		PS		Materiale Propagandistike	23-Pri	Sinjalizues
85		Agjencia Shtetërore e Kadastres Dega Sarande		Shperndarje Certifikata Pronesie	24-Pri	LSI
86		Drejtoria e Bujqesise Vlore dhe Fier		Shperndarje Tollonash	24 - Pri	LSI
87		Ermonela Valikaj		Paralajmerime Aktivitete te Ndaluar	24 - Pri	LSI
88		Anila Denaj		Denoncime per kandidat per deputet	24 - Pri	LSI

Me ngjyrë të gjelbër janë shënuar vendimet e marra gjatë periudhës të këtij raportimi

